



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.2209/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Hysni Ismaili, në çështje juridike kontestimore të paditëses Sh.D., nga P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “K. & A.”, me seli në P., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit, me seli në P., me objekt të kontestit kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 122.4€, jashtë seancës, me datë 20.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT MIRATOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.D., nga P., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të 70% të transportit, për periudhën 21.09.2022 deri me 21.11.2022, për 36 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 25.2€ dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtave ditore), për 36 ditë pune (nga data 21.09.2022 deri me 21.11.2022), t’ia paguajë shumën prej 72€.

II. DETYROHET e paditura që paditëses shumën e gjykuar si në pikën -I- të këtij dispozitivi, t’ia paguaj me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, nga data e parashtrimit të padisë, 07.04.2023, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 124€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses për pagesë në emër të shpenzimeve të transportit përtej shumës së aprovuar në pikën I të këtij dispozitivi dhe atë në shumë prej 25.2€, **SI E PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit së saj, në këtë gjykatë me datë 07.04.2023, ka parashtruar padi me objekt kontesti kompensimi i 70% të transportit rrugor dhe shujtave ditore, e drejtë kjo e garantuar me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë. I autorizuari i paditëses në padi, ka theksuar se paditëses nuk i është bërë kompensimi i 70% të transportit rrugor, për periudhën 21.09.2022 deri me 21.11.2022, për 36 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 50.4€ dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtave ditore), për 36 ditë pune (nga data 21.09.2022 deri me 21.11.2022), t’ia paguajë shumën prej 72€, me kamatë ligjore 8%, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë, duke i propozuar gjykatës që të sjellë aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104€, taksë gjyqësore 21€ dhe për precizimin e padisë shumë prej 104€.

E paditura, në përgjigje në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e udhëtimit si të pabazuar, pasi që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës dhe rrjedhimisht Komuna e Prishtinës gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimit. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e miratoi në tërësi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 2 par. 2 të LPK-së: “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.

Gjykata vlerësoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, sepse nga vërtetimi me numër protokollit 19, të datës 10.01.2024, i lëshuar nga Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë “Avdyl Frashëri”, në P., paditësja për periudhën nga data 21.09.2022 deri me datë 21.11.2022, ka qenë prezente në punë për 36 ditë pune, andaj në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së ku thuhet se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, gjykata ia fali besimin dhe e njëjta si provë ka bashkangjitur certifikatën e banimit si dhe kuponat fiskal me të cilët dëshmohen shpenzimet e krijuara me rastin e udhëtimit, në lartësi prej 0.50€ në një drejtim, andaj si e tillë edhe është aprovuar pjesërisht kërkesa e paditëses për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, si në shumë e gjykuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase paditësja ka pretenduar se shpenzimet vajtje/ardhje arrijnë lartësinë prej 2€ por nga kuponët fiskal të bashkangjitur, vërtetohet se paditësja shpenzime të udhëtimit i ka 1€ në ditë.

Gjykata përmes kontratës së punës me numër të protokollit 137, të datës 22.06.2015, dhe vërtetimit me numër protokollit 19, të datës 10.01.2024, i lëshuar nga Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë “Avdyl Frashëri”, në Prishtinë, mbi ditët e prezencës në punë të paditëses, vërtetoi faktin se paditësja nga data 21.09.2022 deri me datë 21.11.2022, ka qenë prezente në punë për 36 ditë pune. Të cilin vërtetim gjykata e pranoi si provë materiale, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së, ngase i njëjti është dokument i lëshuar nga vet institucionet që hyn në kuadër të të paditurës, andaj vërtetimit si provë me të cilat vërtetohen faktet lidhur me ditët e prezencës në punë, gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga provat e administruara, shihet se paditësja dhe e paditura kanë lidhur marrëdhënie pune, gjë që për palët dhe gjykatën ky fakt nuk ka qenë asnjëherë kontestues, pasi që kjo çështje vërtetohet edhe nga kontrata e punës së paditëses, të nënshkruara me të paditurën, me të cilën është themeluar marrëdhënia e punës, paditësja në cilësinë e mësimdhënëses - punëmarrëse ndërsa e paditura si punëdhënëse

Në nenin 4 par. 2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili është në fuqi parashihet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Ndërsa në nenin 90 të këtij ligji parashihet se “1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet, 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve, 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në, 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes, 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet, 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive dhe 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e themeltë për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit pasi që bazohet në Kontratën Kolektive të Arsimit. Dhe për pjesën tjetër të kompensimit në emër të shpenzimeve të transportit gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin të shpenzimeve të transportit rrugor, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 35, paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, dhe atë bazuar në provat materiale të bashkangjitura në padi, vërtetimit me numër protokoll 19, të datës 10.01.2024, i lëshuar nga Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë “Avdyl Frashëri”, në P., mbi ditët e prezencës në punë të paditëses, kuponët fiskal të bashkangjitur, si dhe certifikatën e vendbanimit me numër serik B..., të datës 09.07.2021, andaj mbi bazën e këtyre provave gjykata ka vërtetuar se vendbanimi i paditëses është në rrugën “UÇK” në P., dhe se kosto ditore e transportit publik për vajtje ardhje është 1€ dhe atë 0.50€, në vajtje dhe 0.50€ në ardhje, ndërsa numri i ditëve prej 36 ditë pune, provohen në bazë të vërtetimit me numër protokoll 19, të datës 10.01.2024, i lëshuar nga Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë “Avdyl Frashëri”, në Prishtinë, (36 ditë, kur shumëzohen me 1 €, përfitohet shuma prej 36€, e që 70% e kësaj shume arrin shumën prej 25.2€), andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi lidhur me shpenzimet e transportit rrugor.

Po ashtu në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi nga data 21.01.2021, parashihet se “të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë

pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë për pagimin e shujtave ditore mori parasysh vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë, nga të cilat rezulton se paditësja nga data 21.09.2022 deri me datë 21.11.2022, ka qenë prezente në punë për 36 ditë pune, andaj edhe shuma prej 72€, është përlllogaritur duke e shumëzuar 36 ditë pune me 2€.

Andaj, provave të lartcekura, gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, për çka edhe duke u bazuar në dispozitat e lartcituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën **III** të këtij dispozitivi, lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses për kompensimin e transportit, në shumë prej 25.2€, pasi që nga kuponat fiskalë të bashkangjitur në shkresat e lëndës gjykata gjeti se shpenzimet e transportit vajtje/ardhje për paditësen arrijnë lartësinë prej 1€ në ditë e jo sa ka pretenduar paditësja me padi në lartësi prej 2€, ashtu që gjykata vlerëson se paditëses i takon e drejta në kompensimit për transport për vetëm 1€ (0.5€ vajtje dhe 0.5€ ardhje) në ditë.

Lidhur me pretendimet e të së paditurës të dhëna në përgjigje në padi se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që t’i përmbushë këto detyrime ndaj paditëses, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj Kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lartë, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë Kontratë Kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste respektivisht nuk ka vijë buxhetore andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është te e paditura e jo te paditësja.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, ku është paraparë se Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit. Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e paraqitjes së padisë 07.04.2023.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 e lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses për padi 104€ dhe për taksë gjyqësore 20€, (sipas nr. tarifor 6 dhe 7, të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për kontestet me vlerë mbi kontestet e vlerës së vogël).

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari
Hysni Ismaili

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.